**L I G J**
**Nr.9076, datë 9.6.2003**

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN PËR VEPRIMTARITË E MISIONIT VËZHGUES TË BASHKIMIT EUROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për veprimtaritë e Misionit Vëzhgues të Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3870, datë 30.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**
**Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN
MBI AKTIVITETET E MISIONIT VËZHGUES TË BASHKIMIT EUROPIAN
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Republika e Shqipërisë, më poshtë e quajtur Palë Pritëse, dhe Bashkimi Europian, së bashku të quajtura Palë Pjesëmarrëse, duke mbajtur parasysh:

- prezencën e Misionit Vëzhgues të Komunitetit Europian (ECMM) në Ballkanin Perëndimor që në vitin 1991;
- marrëveshjen mbi zgjatjen dhe zgjerimin e aktivitetit të Misionit Vëzhgues në Jugosllavi, nënshkruar në Hagë, më 14 tetor 1991;
- memorandumin e mirëkuptimit të Misionit Vëzhgues të Bashkimit Europian në zonën e kufirit të Shqipërisë me ish-Jugosllavinë, nënshkruar në Tiranë më 21 dhjetor 1992;
- prezencën e monitoruesve të Komunitetit Europian/Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë që në vitin 1992;
- miratimin nga Këshilli Europian më 22 dhjetor 2000 të Aktit të Përbashkët 2000/811/PPJS mbi Misionin Vëzhgues të Bashkimit Europian, transformimin e ECMM-së në EUMM, si një instrument të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, bazuar në iniciativat e mëparshme, të kontribuojë në formulimin efektiv të politikës së Bashkimit Europian për vendet e Ballkanit Perëndimor;
- zgjerimin e mandatit të Misionit Vëzhgues të Bashkimit Europian (EUMM) me Aktin e Përbashkët 2001/845/PPJS të datës 29 nëntor 2001,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
**Mandati**

1. Misioni Vëzhgues i Bashkimit Europian, më poshtë i quajtur "EUMM" më parë i njohur në rajon si Misioni Vëzhgues i Komunitetit Europian (ECMM), me zyrën e tij qendrore të vendosur në Sarajevë, do të vendosë zyrën e Misionit të tij në Tiranë dhe zyra të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë, në bazë të vendimit të shefit të Misionit dhe në marrëveshje dhe konsultim me Palën Pritëse, me qëllim që të kontribuojë në një formulim sa më efektiv të politikës së Bashkimit Europian për vendet e Ballkanit Perëndimor.

2. EUMM, do të veprojë në përputhje me mandatin e tij të parashikuar në aktin e përbashkët që rregullon EUMM-në.

3. Pala Pritëse do t'i ofrojë EUMM-së të gjithë informacionin dhe bashkëpunimin e nevojshëm për realizimin e objektivave të EUMM-së. Pala Pritëse mund të caktojë një person kontakti pranë EUMM-së.

Neni 2
**Statusi**

1. Pala Pritëse do të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin e anëtarëve të EUMM-së. Për ndonjë kusht të veçantë, të propozuar nga Pala Pritëse, do të bihet dakord me shefin e Misionit para zbatimit të Marrëveshjes.

2. Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të tij, EUMM-ja dhe personeli i tij do të gëzojnë, së bashku me automjetet dhe pajisjet e tyre, liri lëvizjeje të nevojshme për të realizuar mandatin e Misionit.

3. Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, personeli i EUMM-së mund të shoqërohet nga një përkthyes dhe, me kërkesën e tij, nga një shoqërues të përcaktuar nga Pala Pritëse.

4. EUMM-ja mund të përdorë flamurin e Bashkimit Europian në zyrat e Misionit në Tiranë dhe përndryshe në vende të tjera, sipas vendimit të shefit të Misionit.

5. Automjetet dhe mjetet e tjera të transportit të EUMM-së do të mbajnë shenjën dalluese të identifikimit të Misionit, i cili do t'u bëhet i njohur autoriteteve përkatëse.

Neni 3
**Përbërja**

1. Shefi i Misionit emërohet nga Këshilli i Bashkimit Europian.

2. Personeli tjetër i Misionit përcaktohet nga vendet anëtare të Bashkimit Europian. Ata do të emërohen në postet specifike nga shefi i Misionit që vepron nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm/Përfaqësuesit të Lartë. Norvegjia dhe Sllovakia, që në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje personel, dhe së bashku me Bashkimin Europian dhe vendet anëtare, do të formojnë Palët Dërguese.

3. Personeli i Misionit Vëzhgues do të quhet monitorues.

4. Qeveritë e Palëve Dërguese do të caktojnë monitoruesit në EUMM.

5. Shefi i Misionit do të përcaktojë numrin e monitoruesve në këtë Marrëveshje, mbi bazën e konsultimit dhe marrëveshjes me Palën Pritëse.

6. Monitoruesit nuk do të ndërmarrin ndonjë veprim ose aktivitet që nuk përputhet me natyrën e detyrës së tyre.

7. EUMM-ja mund të shfrytëzojë asistencën e stafit teknik dhe administrativ të Palëve Dërguese. Anëtarët e stafit teknik dhe administrativ të EUMM-së do të gëzojnë një status të barabartë me atë që gëzon stafi administrativ dhe teknik i punësuar në ambasada nga Palët Dërguese, në përputhje me Konventën e Vienës mbi marrëdhëniet diplomatike.

8. Misioni Vëzhgues mund të rekrutojë një personel ndihmës vendas, sipas nevojave. Në bazë të kërkesës së shefit të misionit, Pala Pritëse do të krijojë lehtësira për rekrutimin nga ana e Misionit të një personeli vendas të kualifikuar. Personeli ndihmës i Misionit EUMM do të gëzojë status të njëjtë me atë që gëzon në përputhje me Konventën e Vienës mbi marrëdhëniet diplomatike, stafi vendas i ambasadave.

Neni 4
Armët dhe veshja

1. Monitoruesit nuk mund të mbajnë armë.
2. Monitoruesit do të mbajnë veshje të bardhë civile me shenjën dalluese të EUMM-së.

Neni 5
Shkalla e përgjegjësisë

1. Misioni Vëzhgues në Shqipëri do të veprojë nën përgjegjësinë e shefit të Misionit.
2.Shefi i Misionit do të raportojë rregullisht, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm/Përfaqësuesit të Lartë, në Këshillin e Bashkimit Europian mbi aktivitetet dhe rezultatet e Misionit.
3. Detyrat e EUMM-së do të përcaktohen nga Sekretari Përgjithshëm/Përfaqësuesi i Lartë në bashkëpunim të ngushtë me Presidencën dhe në përputhje me politikën e adaptuar nga Këshilli Europian për vendet e Ballkanit Perëndimor.
4. Shefi i Misionit do të informojë rregullisht Palën Pritëse mbi aktivitetet e EUMM-së.

Neni 6
**Udhëtimi dhe transporti**

1. Automjetet dhe mjetet e tjera të transportit të EUMM-së nuk do të jenë subjekt i detyrueshëm regjistrimi ose licencimi dhe të gjitha mjetet do të kenë sigurimin e një pale të tretë.
2. Misioni Vëzhgues mund të përdorë rrugë, ura, kanale, lehtësi portuale dhe aeroportuale, pa pagim të taksave ose tatimeve.
3. Pala Pritëse do t'i krijojë lehtësira Misionit Vëzhgues në përdorimin e automjeteve të tij dhe mjeteve të tjera të transportit.

Neni 7
**Komunikimi**

1. Personeli i EUMM-së gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tij do të ketë akses, me koston më të ulët, në përdorimin e pajisjeve përkatëse të telekomunikimit të Palës Pritëse, përfshirë komunikimin me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Palëve Dërguese.
2. EUMM-ja do të gëzojë të drejtën e komunikimit të pakufizuar nëpërmjet radiove të tij (përfshirë ato satelitore, të lëvizshme dhe portative), telefonave, telegrafëve, faksit dhe mjeteve të tjera. Pala Pritëse do të ofrojë, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, frekuencat e radiove në të cilat do të veprojnë.

Neni 8
**Privilegjet dhe imunitetet**

1. EUMM-së do t'i jepet statusi i Misionit Diplomatik.
2. Monitoruesve, gjatë misionit të tyre, do t'u akordohen privilegjet dhe imunitetet e agjentit diplomatik në përputhje me Konventën e Vienës për marrëdhëniet diplomatike.
3. Zyra e Misionit në Tiranë, zyra të tjera dhe gjithë mjetet e transportit të Misionit EUMM do të jenë të padhunueshme.
4. Privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara nga ky nen do t'u jepen monitoruesve gjatë misionit të tyre, dhe më pas, për akte të kryera më parë gjatë misionit të tyre.

5. Pala Pritëse do të krijojë lehtësira për lëvizjen e shefit të Misionit dhe personelit të EUMM-së. Misioni do t'i ofrojë Palës Pritëse një listë të anëtarëve të tij dhe do ta informojë Palën Pritëse paraprakisht mbi arritjen dhe largimin e personelit që i përket Misionit. Personeli që i përket Misionit Vëzhgues do të mbajë pasaportat përkatëse kombëtare, si dhe një kartë identiteti të Misionit.
6. Pala Pritëse njeh të drejtën e Palëve Dërguese dhe të EUMM-së për të importuar pa taksa

ose kufizime të tjera, pajisje, furnizime ose mallra të tjera që nevojiten për përdorim ekskluziv dhe zyrtar të Misionit. Pala Pritëse njeh gjithashtu të drejtën e blerjes të sendeve të tilla në territorin e Palës Pritëse, si dhe të eksportimit të pajisjeve të tilla, furnizimeve dhe mallrave të tjera që janë blerë në këtë mënyrë ose janë importuar. Pala Pritëse njeh gjithashtu të drejtën e monitoruesve për të blerë dhe/ose importuar pa taksa apo kufizime të tjera të sendeve për përdorim personal dhe për t'i eksportuar këto sende.

Neni 9

**Strehimi dhe rregullime të tjera praktike**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon, nëse i kërkohet, që të ndihmojë EUMM-në në gjetjen e zyrave dhe strehimit të përshtatshëm. Palët Pjesëmarrëse do të vendosin mbi masa të tjera që lidhen me privilegjet dhe imunitetet dhe për rregullime të tjera praktike, që përfshijnë ndihmën mjekësore dhe evakuimin urgjent, si dhe mbi kërkesat e dokumentacionit të udhëtimit.

Neni 10

**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht që nga data e nënshkrimit dhe do të hyjë në fuqi, kur EUMM-ja do të marrë njoftimin me shkrim nga Pala Pritëse se janë plotësuar procedurat e saj të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ajo do të mbetet në fuqi deri në atë kohë kur njëra nga Palët Pjesëmarrëse njofton Palën tjetër, dy muaj përpara, se ajo synon t'i japë fund aktiviteteve të përmendura në këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 28 mars 2003 në gjuhët shqip dhe anglisht, të gjitha të barasvlefshme. Në rast ndryshimesh në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.